

## “Samiti i Grave të Biznesit” më 16-18 Janar 2020, Tiranë



Për herë të parë, organizohet “Samiti i Grave të Biznesit” në datat 16, 17 dhe 18 Janar 2020 në Hotel Rogner, Tiranë. Eventi organizohet nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën me mbështetjen e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Në event do të zhvillohen disa panele diskutimi mbi rolin e gruas shqiptare nga Diaspora në fushën e biznesit si dhe sfidat e tyre për integrim në tregun ekonomik në Shqipëri. Eventi synon nxitjen e një bashkëpunimi dhe njohjen me sipërmarrjet e suksesshme shqiptare nga drejtuese gra në vendin tonë.

## Publikohet “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”



Botimi vjetor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës “Politika Shtetërore për Diasporën 2019” është publikimi pasardhës i “Politikës Shtetërore për Diasporën 2018”. Ky vëllim vlerëson zbatimin e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për Diasporën gjatë këtij viti. Politika shtetërore për Diasporën synon mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, nxitjen e angazhimit të tyre në jetën sociale dhe politike dhe rritjen e kontributit në vendin e origjinës. Materialet e përfshira në këtë botim shërbejnë për informimin e publikut brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e veprimtarisë së institucioneve shtetërore si edhe politikave të legjislativës dhe të drejtuesve të Diasporës shqiptare.

## Buletini dhjetor 2019 për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës



Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Buletini nr. 4 (dhjetor 2019) është vazhdim i publikimeve të mëparshme dhe në të jepet një informacion i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare të Diasporës nga institucionet shtetërore përgjegjëse për politikave të Diasporës. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave shtetërore për Diasporën. Gjithashtu, publikimi i Buletinit informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikave ekzistuese, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë reformës shtetërore për Diasporën.

## Publikohet “Periodik II 2019 Diaspora Shqiptare”



Në muajin Dhjetor 2019, u publikua “Periodik II 2019 Diaspora Shqiptare” Analiza dhe Studime. Ky është një publikim i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i cili del çdo gjashtë muaj dhe është publikimi pasardhës i Periodikut I. Në botimin e parë të Periodikut, u prezantua projekti “Diaspora për Zhvillim” aspekte ekonomike dhe analiza mbi Diasporën shqiptare. Vëllimi i dytë informon më tepër mbi aspektet ekonomike të Diasporës shqiptare, çështjet e politikave gjuhësore në shkollat e komunitetit shqiptar në Diasporë si dhe sjell një përmbledhje të kontributeve të Diasporës dhe migrimit në konferencën “Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore”. Ky botim periodik vjen me një risi pasi prezantohen dy projektet e reja në zbatim nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, të cilat janë Projekti “Për Dhomën e Biznesit të Diasporës – Krijimi dhe nxitja e investimeve të Diasporës në Shqipëri” dhe projekti “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e Integritimit Europian të Shqipërisë”.

## Zhvillohet mbledhja e parë e Këshillit Drejtues të FSHZHD për vitin 2020

Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës zhvilloi mbledhjen e tij të parë për vitin 2020. Qëllimi i mbledhjes ishte prezantimi dhe kalimi për miratim i buxheteve vjetore për projektet në zbatim nga ky institucion. Gjatë mbledhjes, u prezantua marrëveshja e financimit midis Konfederatës Zvicerane dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për projektin e “Gazetës së Diasporës”. Me rëndësi të veçantë ishte prezantimi i aktivitetit “Samiti i Grave të Biznesit”, i cili do të zhvillohet në Tiranë, më 16-18 Janar 2020. Ky aktivitet synon nxitjen e një bashkëpunimi dhe njohjen mes sipërmarrëseve të Diasporës dhe atyre vendase. Anëtarët e Këshillit Drejtues u informuan edhe mbi anëtarësimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe të Dhomës së Biznesit të Diasporës në Këshillin e Investimeve, si dhe kalimin për miratim të disa procedurave administrative.

## Greqi / Marrëveshja për njohjen e patentave shqiptare



Marrëveshja për njohjen e patentave shqiptare në Greqi është dërguar për miratim në parlamentin grek më 30 dhjetor 2019 dhe miratimi i saj pritet të jetë një nga aktet e para të ligjvënësve grekë për vitin 2020. Sipas kësaj marrëveshjeje, të gjithë shtetasit shqiptarë në Greqi do të mund të konvertojnë patentat e tyre shqiptare me patentat greke. Konvertimi i patentave do të bëhet pa pasur nevojë kryerjen e testeve teorike dhe praktike. Kjo marrëveshjeje u firmos në Athinë në maj të vitit 2018, por për të hyrë në fuqi kërkohet miratimi i saj në të dy parlamentet. Parlamenti shqiptar e miratoi në korrik të vitit 2018.




## KKD / Gazmend Kapllani, vepra e tij së shpejti në arabisht



Romani “Ditar i shkurtër kufjesh” i autorit dhe anëtarit të Këshillit Koordinues të Diasporës, Gazmend Kapllani do të përkthehet edhe në arabisht. Lajmi është bërë i ditur nga vetë autori, i cili në rrjetin e tij social “Facebook” ka bërë të ditur emrin e përkthyesit dhe shtëpinë botuese që do ta sjellë veprën e tij në gjuhën arabe. “Romani im i parë “Ditar i shkurtër kufjesh” vjen së shpejti në arabisht. E përkthyer nga frëngjishtja kësaj here në arabisht. I lumtur për këtë rrugëtim të ri për të një kufri. Falënderime të përzemërta për përkthyesin Ahmed El luizi dhe Shtëpinë Botuese Dar Athar”, ka shkruar Kapllani. Kjo veprë e përkthyer së fundmi në frëngjisht është vlerësuar pozitivisht nga kritika ndërkombëtare.

## Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## “Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin “e-Albania”.